

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

E HËNË 23 MAJ 2022

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Një grup deputetësh kanë paraqitur para pak ditësh një mocion me debat për një problem shumë delikat e kritik, i cili ndodh veçanërisht në një moment shumë kyç, siç është ai i hapjes së negociatave për anëtarësim në Bashkimin Europian. Pikërisht në këtë moment, nga Kryeministri i vendit në Bruksel, në mënyrë jo të papërgjegjshme, por me një strategji shumë të qartë për të mos e mbështetur e penguar këtë proces, është bërë një deklaram shumë i rëndë. Praktikisht, Kryeministri ka deklaruar (po e citoj ad litteram): “Ndërkohë, besoj se të gjithë e kanë të qartë se kjo situatë nuk mund të vazhdojë më gjatë.

Megjithatë, ne do të ndryshojmë menjëherë kurs, siç kemi thënë dhe siç kemi marrë nga këshilli kombëtar, në rast se vendi ynë nuk do të kalojë në fazën tjetër për t’u ulur formalisht në tryezë për negociatë”. Është fare e qartë për këdo që ky është thjesht dhe vetëm një qëndrim provokativ ndaj një shtate, e cila për sa i përket integritit europian është rënduar jo për faj të europianëve, sepse shpeshherë Kuvendi i Shqipërisë, maxhoranca, Kryeministri, në radhë të parë, ministra e të tjerë deputetë kanë folur këtu sikur janë ata përfaqësues të Europës, kanë shpjeguar ata se çfarë problemesh ka Europa, i kanë dhënë mend Europës se si duhet të dalë ajo nga problemet e saj, sepse problemet tona ne i kemi dritë dhe pasqyrë! Po të shikohej, ashtu siç është thënë, fjalë për fjalë, po të mos ishte për prapaska të tjera, ky do të ishte një debilitet politik, por i lidhur me strategjinë shumë të errët të Ballkanit të Hapur dhe me njëmijë elemente të tjera, të cilat e kanë shtyrë vazhdimisht Kryeministrin për të treguar se ai nuk sheh nga Perëndimi (nuk ka arsye përse të shohë nga Perëndimi, se ky i fundit është një pasqyrë ku realiteti i qeverisjes së tij del shumë shtrembër), aksi i tij është nga Lindja.

Rruga e Perëndimit për të kalon nga Beogradi. Sigurisht, të thuash që ne do të ndryshojmë menjëherë kurs, se këtë porosi e kemi marrë nga këshillimi kombëtar, është antikushtetuese, antiligjore dhe provokative, nuk është shprehje e vullnetit të popullit, që realizohet me mekanizimin e këshillit kombëtar të paguar, të sponsorizuar e të manipuluar nga Kryeministri. Populli shqiptar e ka mekanizmin, ka referendumin. Për të ndarë se nga do të shkojë Shqipëria (këta ia kanë vënë emrin vetes “Rilindje”,

por Rilindja dhe rilindësit thoshin që dielli për Shqipërinë lind nga Perëndimi, për këta lind ashtu siç është natyrshëm, nga Lindja), për të ndryshuar kursin dhe për t'u shprehur kundër dhe në emër të popullit, ka një mekanizëm, që është referendumit; nuk ka këshillime kombëtare.

Nuk është histori patronazhistësh kjo. Thënë kjo, pra ai momenti shumë delikat, siç është qershori e, duke qenë një qëndrim i përsëritur, sigurisht, i qëllimtë, patjetër që kërkon një mocion me një debat të gjerë, për t'u rikonfirmuar të gjithë atyre që e monitorojnë këtë vend, por që kanë edhe autoritetin për të marrë vendime për këtë proces jetik e të patjetërsueshëm, siç është integrimi Europian dhe anëtarësimi në BE, një rishprehje vullneti, për të shpjeguar dhe për të ndarë qartë me ta, që shqiptarët në këtë çështje janë të gjithë bllok e nuk kanë asnjë dyshim, por kanë një Kryeministër, interesat e të cilit nuk shkojnë dhe nuk kanë për të shkuar kurrë nga Perëndimi, sepse është i njëjti Kryeministër që qan e lan e mallëngjehet kur Bashkimi Europian bën procedura për të ndihmuar për rindërtimin dhe organizon konferenca, ku grumbullohen deri në 1,2 miliardë euro, ndërsa të nesërmen i tregohet munxa Perëndimit; Kryeministri i këtij vendi të madh si Shqipëria, të fuqishëm që prin Europën!

Kompleksi i fanarit ndriçues, që jemi ne ata që i japim mend Europës, që i japim të kuptojë se çfarë duhet të ndryshojë ajo, si duhet të përmirësohet e të demokratizohet, e thashë edhe një herë tjetër, në pamje të parë do të ishte imbecile-et politik, por nuk është i tillë. Këto janë me një qëllim e një strategji të përcaktuar mirë. Është e çuditshme se si maxhoranca nuk e do këtë mocion dhe e kundërshton, sepse një mocion, i cili rishpreh dhe rikonfirmon vullnetin e palëkundur për integrimin europian është një e mirë që i shkon edhe maxhorancës (bëhet fjalë gjithmonë për maxhoranca që kanë largpamësi dhe vizion, jo për maxhoranca dritëshkurtra e që punojnë në bazë të emocioneve të ditës së Kryeministrit apo interesave të tij). Ashtu sikurse e citoi Kryetarja e Kuvendit, me demok Konferenca e Kryetarëve nuk e pranoi kërkesës, sepse nuk ishte në rregull formalisht! Patëm mundësi ta ndanim me ju këtë, t'ia shpjegonim dhe Konferencës së Kryetarëve, sepse njeriu, kur do ta fshehë gjënë e madhe pas gishtit, bëhet më pak se qesharak.

Do të dëgjoni dhe më mbrapa që do të vijojnë të bëhen qesharakë e do të thonë që aty ishte vënë fjala "urgjent", e cila na prish ne pjesën formale të paraqitjes së mocionit! Ata që e lexuan, se ka prej tyre që kanë ardhur më vonë sesa ne në parlament, e dinë shumë mirë që, fjala "urgjent", për të sqaruar dhe teleshikuesit që na ndjekin, ishte shënuar ne germa të mëdha, për të dhënë të kuptojë që ka urgjencë kjo punë, qershori është aty, te pragu i derës, dhe duhet ta bëjmë patjetër këtë debat në kohën e duhur, jo ta bëjmë debatin si me rezolutën e Srebrenicës, që nuk do ta bëjmë tani, por do ta bëjmë pas disa

muajsh. Këto janë truke të një provincializmi politik të padëgjuar dhe qesharak. Mund të vazhdoni ta mbronni këtë gjë, mund të vazhdoni ta mbronni këtë budallallëk, edhe pasi të flas unë.

Ajo që nuk lëviz është që kjo deklaratë shumë e rëndë është bërë në mes të Brukselit, me qëllim, për t'u dhënë të kuptojnë të gjithëve dhe për të krijuar alibinë për të vazhduar atë ndryshim kursi, që ka filluar, sepse që ditën kur ne këtu refuzuam amendamentin për daljen nga Ballkani i Hapur, në raport shumë të ngushtë me një vend si Serbia, e cila u shpreh hapur e qartë kundër sanksioneve ndaj Rusisë, pra dhe në momentin më delikat, kur bota është ndarë më qartë se kurrë ndonjëherë në këta 50-60 vjetët e fundit, kjo maxhorancë zgjodhi pikërisht anën e errët, sigurisht, jo vetë, se nuk ka personalitet kjo maxhorancë ta bëjë vetë këtë, por me urdhër të kryeministrit. Sot nevoja për ta bërë këtë debat urgjent, po e them edhe një herë tjetër, nuk ishte aspak në të mirë të opozitës.

Kjo ishte vetëm e vetëm në të mirë të Kuvendit të Shqipërisë, i cili është institucioni që formëson të gjitha institucionet e këtij vendi, e për t'u dëshmuar atyre, që janë vendimmarrësit e mëdhenj të këtij procesi, se nuk jemi ne ata që do t'i tregojmë Europës se si ndryshojmë apo lëvizim kursin dhe mezi po presin ata të dëgjojnë se cili është kursi ynë, se e njohën shumë mirë se cila është Shqipëria, dhe Shqipëria e vërtetë është ajo e rezolutës së miratuar më 19 maj, ku skaneri është i pamëshirshëm dhe tregon shumë qartë se problemet janë thelluar, janë rënduar dhe kanë dalë nga kontrolli qëllimisht nga qeveria, në të gjitha aspektet. Dita është e gjatë dhe ne do të kemi mundësi ta diskutojmë këtë çështje. Sigurisht, edhe në qoftë se (me sa duket, do të ndodhë) do ta mohoni këtë mocion, ai do të jetë temë e të gjitha diskutimeve e debateve tona dhe asnjë truk, për t'u fshehur pas ca dënglave procedurale të paqena e të stisura, nuk mund ta ndalë këtë.

Sinqerisht, edhe një herë, në emër të së mirës së madhe, për të treguar se ku jemi në raport, që ne nuk jemi pro sanksioneve, pro Ballkanit të Hapur, e keni dhe në rezolutë që nuk mbështetet nga Europa, apo pro çdo lloj negativiteti, debati do t'ju bënte mirë për të "shëruar" të gjitha këto gafa të tmerrshme, që rëndojnë mbi Shqipërinë. Prandaj mos e refuzoni, mos u trembni për ta bërë këtë debat e mos u fshihni pas gishtit me dëngla procedurale.